

Nr	Viti	Kontratë Sponsorizimi	Sponsorizuesi	Përfituesi	Objekti i Kontratës	Vlera
1	2016	nr.57497, dt.10.11.2016	Credins Bank	ATP	Sistemi i Menaxhimit të Radhës në Sportele	€ 10,000.00
2	2017	nr.37011,dt.21.07.2017	Credins Bank	ATP	Rikonstruksioni i Ambjenteve të ATP	€ 6,000.00
3	2021	nr.47793, dt.20.10.2021	Credins Bank	ATP	Shpenzime për Mirëmbajtjen e Objekteve Ndertimore nga Termeti	€ 15,000.00

Nr. 57697 Prot. Dt. 10 / 11 / 2016Nr. 4018 Prot. Dt. 10 / 11 / 2016**KONTRATË SPONSORIZIMI**

- I. Shoqëria aksionere **"BANKA CREDINS" Sh.a.**, me adresë Rr. "Vaso Pasha", Nr. 4, një shoqëri e krijuar që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr.28969, Dt.31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K316088010 si dhe me licencën Nr.16, Dt.31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, që ligjërisht përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm, **Z. Maltin KORKUTI**, këtu e më poshtë i quajtur **"Sponsorizuesi"**.

Dhe

- II. **AGJENCIA E TRAJTIMIT TE PRONAVE**, me adresen, rruga Muhamet Gjollësia, Nr.54, Tiranë, Shqiperi që ligjërisht përfaqësohet nga **znj. Sonila QATO** këtu e më poshtë i quajtur **"Përfituesi"**.

Palët në këtë kontratë kanë rënë dakord për përpilimin dhe nënshkrimin e saj me termat dhe afatet e mëposhtme:

**Neni 1
BAZA LIGJORE**

- 1.1 Ligji nr.7892 datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet" i ndryshuar, Ligji nr.8438, datë 28.11.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar).

**Neni 2
OBJEKTI I KONTRATËS**

- 2.1 Objekt i kësaj kontrate do të jetë sponsorizimi nga ana e **Sponsorizuesit** në favor të **Përfituesit** me qëllim mbulimin e shpenzimeve për Sistemin për menaxhimin e radhes ne sportele", me një vlerë prej 10,000 euro (dhjetemije euro) përfshirë Taksat e Aplikueshme.

**Neni 3
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE**

- 3.1 Palët kanë rënë dakord dhe marrin përsipër:
3.1.1 Bashkëlidhur kësaj kontrate dhe pjesë integrale e saj do të jetë dokumentacioni justifikues i shpenzimeve të kryera për përmbushjen e qëllimit të sponsorizimit.

3.1.2 Kryerja e sponsorizimit do të dokumentohet në pajtim me legjislacionin tatimor kontabël bankar në fuqi.

3.1.3 Përfitoesi merr përsipër të reklamoj emrin e mirë të bankës dhe të lejojë bankën të realizojë promociione informuese per produktet dhe shërbimet e reja per stafin e institucionit.

Neni 4 AFATI I KONTRATËS

- 4.1 Kjo kontratë lidhet në datë ____/____/2016 dhe kohëzgjatja e saj përcaktohet për një periudhë 12 mujore nga kjo datë.
- 4.2 Secila palë rezervon të drejtën për tu tërhequr nga kjo kontratë, por jo më parë se ai të ketë njoftuar palën tjetër me shkrim të paktën 5 ditë kalendarike përpara nga data e prishjes së saj.

Neni 6 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 6.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate do të jenë objekt i zgjidhjes me mirëkuptim, dhe në rast se një gjë e tillë nuk arrihet, palëve ju lind e drejta t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nenin 7 TE NDRYSHME

- 7.1 Kryerja e sponsorizimit do të dokumentohet në pajtim me legjislacionin tatimor kontabël e bankar në fuqi.
- 7.2 Bashkëlidhur kësaj kontrate dhe pjesë integrale e saj do të jetë dokumentacioni justifikues i shpenzimeve (fatura tatimore) të kryera për përmbushjen e qëllimit të sponsorizimit, ku sponsorizuesi është në cilësinë e blerësit.
- 7.3 Palët pasi e lexojnë dhe e kuptojnë këtë kontratë, e nënshkruajnë rregullisht me vullnetin e tyre të plotë e të lirë.
- 7.4 Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje me fuqi të barabartë juridike, dy për secilën palë.

PALET

SPONSORIZUESI

BANKA CREDINS SH.A

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM




PËRFITUESI

AGJENCIA E TRAJTIMIT TE PRONAVE

Sonila QATO

DREJTOR I PERGJITHSHEM



CREDINS BANK

Nr. Prot 47793

Dt: 20.10.21

Agjencia e Trajtimit të Pronave

Nr. Prot 7369/1
20.10.2021**KONTRATË SPONSORIZIMI**

Kjo Kontratë Sponsorizimi (“Kontrata”) lidhet sot, më datë 20/10/21, në Tiranë ndërmjet palëve të mëposhtme:

Shoqëria “**BANKA CREDINS**” Sh.a., me adresë Rr.“Vaso Pasha”, Nr. 8, një shoqëri e krijuar që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr.28969, Dt.31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K316088010 si dhe me licencën Nr.16, Dt.31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, që ligjërisht përfaqësohet nga Zv. Drejtore e Përgjithshme, Znj. Monika Milo, këtu e më poshtë e quajtur “Banka”.

dhe

Agjencia e Trajtimit të Pronave, me adresë Rr. Muhamet Gjolleasha, Nr.54, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori **znj.Jonida Baci**, këtu e në vijim referuar si “**Përfituesi**”

Të dy së bashku referuar si “**Palët**” dhe individualisht si “**Pala**”.

**NENI 1
BAZA LIGJORE**

1.1 Kjo Kontratë është përgatitur në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar. Të gjitha kushtet e tjera që nuk trajtohen në këtë kontratë do të jenë të zbatueshme për palët sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**NENI 2
OBJEKTI I KONTRATËS**

- 2.1 Objekt i kësaj kontrate është sponsorizimi i Përfituesit me shumën totale prej **15.000 €** (përfshirë të gjitha taksat dhe detyrimet sipas legjislacionit në fuqi).
- 2.2 Kjo vlerë do të mbulojë shpenzimet për mirëmbajtjen e objektit ndërtimor të disa zyrave dhe ambienteve të dëmtuar nga tërmeti në emër dhe për llogari të Përfituesit, në përputhje me kushtet dhe termat e kësaj kontrate.

**NENI 3
AFATI I KONTRATËS**

- 3.1 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe do të jetë e vlefshme deri në përfundim të aktivitetit objekt sponsorizimi.
- 3.2 Kjo Kontratë mund të përfundojë përpara afatit të saj për arsyet e parashikuara në këtë kontratë.

NENI 4 TË DREJTA DHE DETYRIMET E SPONSORIT

- 4.1 Credins Bank do të jetë Sponsor i Përfituesit në shumën totale prej **15.000 €** (përfshirë të gjitha taksat dhe detyrimet sipas legjislacionit në fuqi), shumë e cila do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e objektit ndërtimor të disa zyrave dhe ambienteve të dëmtuar nga tërmeti.
- 4.2 Paguesa do të kryhet brenda 20 ditësh nga lëshimi i faturës tatimore. Fatura do të përmbajë të gjithë zërat e shpenzimeve të realizuara për realizimin sipas objektit të sponsorizimit.
- 4.3 Sponsorin zgjedh dhe vendos se cili format grafik do të përdoret nga Përfituesi si shenjë mirënjohje dhe falënderimi nga ana e Përfituesit.
- 4.4 Sponsorin ka të drejtë të kërkojë t'i rimburohet vlera e shërbimit të sponsorizuar në kuadër të kësaj kontrate, në rast se Përfituesi shkel apo nuk respekton parashikimet e kësaj Kontrate.
- 4.5 Sponsorin ka të drejtë të ndërpresë në mënyrë të menjëhershme këtë kontratë si dhe të rimburohet menjëherë për të gjitha shpenzimet e tij në rast se Përfituesi nuk do të zbatojë ndonjë apo të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë Kontratë.

NENI 5 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- 5.1 Përfituesi merr përsipër dhe garanton se sponsorizimi i akorduar nga Sponsorin do të përdoret vetëm për nevojat e Përfituesit të lidhura me organizimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e objektit ndërtimor të disa zyrave dhe ambienteve të dëmtuar nga tërmeti, në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.
- 5.2 Përfituesi nuk do të kërkojë asnjë pagesë tjetër dhe/apo formë tjetër pagese dhe/ose shërbimi përveç atyre të parashikuara në këtë Kontratë.
- 5.3 Përfituesi detyrohet të mos keqpërdorë imazhin dhe/ose logon e Sponsorit në asnjë formë apo mënyrë dhe se do ta përdorë atë vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë kontratë dhe në rast të kundërt do të shpërblejë Sponsorin për dëmet e shkaktuara.
- 5.4 Përfituesi në shenjë mirënjohje për sponsorizimin dhe mbështetjen e Sponsorit mundëson:
 - a) falënderimin e Sponsorit për mbështetjen e dhënë në të gjitha mënyrat e komunikimit të eventit.
- 5.5 Në rast se Përfituesi nuk respekton apo shkel parashikimet e kësaj Kontrate apo nëse eventit/et objekt sponsorizimi nuk realizohen, Palët përkatësisht do t'i rimburojnë Sponsorin shumën e sponsorizimit të dhënë.
- 5.6 Përfituesi do të depozitojë në arshivën e Sponsorizuesit dokumentet përkatëse, të cilat vërtetojnë realizimin e Sponsorizimit, në përputhje me ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", i ndryshuar, të cilat do të jenë:
 - a) foto të realizuara gjatë vlefshmërisë së kësaj Kontrate;
 - b) video të realizuara gjatë vlefshmërisë së kësaj Kontrate.
- 5.7 Përfituesi nuk ka të drejtë të ndryshojë Aneksin 1 të kësaj kontrate, pa marrë miratimin me shkrim të Credins Bank.
- 5.8 Përfituesi është përgjegjës për realizimin e mirëmbajtjes së objektit ndërtimor të disa zyrave dhe ambienteve të dëmtuar nga tërmeti në lidhje me sasinë, cilësinë, llojin, mënyrën, madhësinë e produktit/shërbimit të përcaktuar në Aneksin 1, të cilat në asnjë rast nuk do të tejkalojnë vlerën e përcaktuar në Aneksin 1.
- 5.9 Përfituesi do të depozitojë pranë Sponsorit një informacion zyrtar për të konfirmuar dhe vërtetuar realizimin dhe vënien në dispozicion të shërbimit të përcaktuar në Aneksin 1 të kësaj Kontrate.

5.10 Credins Bank përfiton në përputhje me shumën e sponsorizimit:

- a) vendosjen e logos së kompanisë në banerin kryesor dhe në materialet e eventit,

NENI 6

ZGJIDHJA E KONTRATËS

- 6.1** Kjo Kontratë do të përfundojë me përfundimin e afatit të parashikuar në Nenin 2. Kjo kontratë do të zgjidhet në mënyrë të menjëhershme nga Sponsor, si dhe Sponsor do të rimburohet për të gjitha pagesat e kryera prej tij, në rast se Përfituesi nuk do të respektojë detyrimet e ndërmarra në këtë Kontratë.
- 6.2** Asnjëra nga palët nuk do të ketë asnjë përgjegjësi në rast të mos zbatimit të pjesshëm apo të plotë të kësaj Kontrate për shkak të Forcës Madhore. Forca Madhore përfshin por nuk kufizohet në ngjarje të tilla si: fatkeqësi natyrore, si zjarri, përmytja, stuhitë, grevat, legjislacioni, rregulla ose kufizime shtetërore, mungesë e përgjithshme e dritave, prishje e rendit publik, luftë civile, grusht shteti, luftëra dhe armiqësi ndërkombëtare apo ndonjë shkak tjetër përtej kontrollit të arsyeshëm të asaj pale dhe që ndodh jo për fajin e apo nga neglizhenca e saj.

NENI 7

KOMUNIKIMET NDËRMJET PALËVE

7.1 Palët do t'i komunikojnë njëri-tjetrit njoftimet në lidhje me këtë Kontratë në adresat e mëposhtme:

Credins Bank sh.a.
Person kontakti:
Tel: 0694066392

(Sponsori)
Gerti Ruçi
e-mail: gerti.ruci@bankacredins.com

Agjencia e Trajtimit të Pronave
Person kontakti:
Tel: 0698726631

(Përfituesi)
Entela Imeri
e-mail: mirientela@gmail.com

7.2 Për çdo ndryshim në adresat e mësipërme, palët do të njoftojnë njëra-tjetrën, në të kundërt asnjëra prej palëve nuk do të marrë asnjë përgjegjësi për mos marrjen e njoftimit në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate.

NENI 8

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

8.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga dhe për zbatimin e kësaj Kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim nga palët. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre do jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 9

TË NDRYSHME

9.1 Kjo Kontratë lidhet me mirëkuptimin e plotë të përfaqësuesve të palëve dhe përbën marrëveshjen e plotë dhe të vetme ndërmjet tyre. Marrëveshjet me gojë të bëra gjatë negociatave për lidhjen e kësaj kontrate nuk janë pjesë e kësaj kontrate.

9.2 Çdo ndryshim apo modifikim në kushtet e kësaj kontratë do të jetë i vlefshëm pasi të bëhet në formë të shkruar dhe të firmoset nga të 2 (dy) palët.

9.3 Pjesë integrale e kësaj Kontrate është dhe Aneksi 1.

9.4 Kjo Kontratë do të trajtohet si konfidenciale dhe asnjë nga palët nuk do të ketë të drejtë të bëjë publike përmbajtjen e saj, përjashtimisht kur kërkohet për efekt dokumentacioni nga organet shtetërore sipas rasteve të parashikuara me ligj.

9.5 Kjo Kontratë është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga të cilat dy kopje për sponsorin dhe një kopje për përfituesin.

Me anë të këtij nënshkrimi ne deklarojmë se i kemi lexuar, kuptuar dhe pranuar nenet, dispozitat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.

Për Sponsorin

CREDINS BANK SH.A.

Monika Milo
Zv. Drejtore e Përgjithshme



Për Përfituesin

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE


Jonida Baci
Drejtori



Nr. 57011 Prot. Dt. 21/07/2017

Nr. 7021 Prot. Dt. 21/7/2017

KONTRATË SPONSORIZIMI

- I. Shoqëria aksionere **"BANKA CREDINS" Sh.a.**, me adresë Rr. "Vaso Pasha", Nr. 8, një shoqëri e krijuar që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr.28969, Dt.31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K316088010 si dhe me licencën Nr.16, Dt.31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, që ligjërisht përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm, **Z. Maltin KORKUTI**, këtu e më poshtë i quajtur **"Sponsorizuesi"**.

Dhe

- II. **AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE**, me adresën, Sheshi Qemal Ataturk, Tirane, Shqipëri që ligjërisht përfaqësohet nga **Znj. Sonila QATO** këtu e më poshtë e quajtur **"Përfituesi"**.

Palët në këtë kontratë kanë rënë dakord për përpilimin dhe nënshkrimin e saj me termat dhe afatet e mëposhtme:

Neni 1 BAZA LIGJORE

- 1.1 Ligji nr.7892 datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet" i ndryshuar, Ligji nr.8438, datë 28.11.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar).

Neni 2 OBJEKTI I KONTRATËS

- 2.1 Objekt i kësaj kontratë do të jetë sponsorizimi nga ana e **Sponsorizuesit** në favor të **Përfituesit** me qëllim mbulimin e shpenzimeve për rikonstruksionin e ambienteve me një vlerë prej 6.000 (gjashtë mijë) EURO përfshirë taksën e aplikueshme.

3.1 Palët kanë rënë dakord dhe marrin përsipër:

- 3.1.1 Bashkëlidhur kësaj kontrate dhe pjesë integrale e saj do të jetë dokumentacioni justifikues i shpenzimeve të kryera për përmbushjen e qëllimit të sponsorizimit, fatura tatimore ku në cilësinë e blerësit duhet të jetë Institucioni.
- 3.1.2 Kryerja e sponsorizimit do të dokumentohet në pajtim me legjislacionin tatimor kontabël bankar në fuqi.
- 3.1.3 Përfituesi merr përsipër të reklamojë emrin e mirë të bankës duke siguruar mirëmbajtjen e marrëdhënieve me institucionin.

Neni 4 AFATI I KONTRATËS

- 4.1 Kjo kontratë lidhet në datë ____ / ____ 2017 dhe kohëzgjatja e saj përcaktohet për një periudhë 90 ditë nga kjo datë.
- 4.2 Secila palë rezervon të drejtën për tu tërhequr nga kjo kontratë, por jo më parë se ai të ketë njoftuar palën tjetër me shkrim të paktën 5 ditë kalendarike përpara nga data e prishjes së saj.

Neni 6 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 6.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate do të jenë objekt i zgjidhjes me mirëkuptim, dhe në rast se një gjë e tillë nuk arrihet, palëve ju lind e drejta t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nenin 7 TE NDRYSHME

- 7.1 Kryerja e sponsorizimit do të dokumentohet në pajtim me legjislacionin tatimor kontabël e bankar në fuqi.
- 7.2 Bashkëlidhur kësaj kontrate dhe pjesë integrale e saj do të jetë dokumentacioni justifikues i shpenzimeve (fatura tatimore) të kryera për përmbushjen e qëllimit të sponsorizimit, ku në cilësinë e blerësit duhet të jetë Institucioni.
- 7.3 Palët pasi e lexojnë dhe e kuptojnë këtë kontratë, e nënshkruajnë rregullisht me vullnetin e tyre të plotë e të lirë.
- 7.4 Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje me fuqi të barabartë juridike, dy për secilën palë.

PALËT

SPONSORIZUESI

BANKA CREDINS SH.A

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



PËRFITUESI

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

Sonila QATO

DREJTORE E PËRGJITHSHME

